



Pranuar / Dorezuar Prijmljeno/Prodato Received/Deliverty	28.12.2021	viti god year	1
Organ /Injesia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHOCK	6356/2021		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.Nr.997/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Jeton Koca dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.997/2021 të datës 03.12.2021 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi Rr.“Pren Doci”, Nr.30, Prishtinë, kundër organit të punësimit Agjencia Kosovare e Privatizimit, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 si dhe neni 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 i Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 28.12.2021, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar me ankesën me numër A.nr.997/2021 të datës 03.12.2021 të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi më datë 03.12.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 5788/2021, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër heshtjes Administrative të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, me pretendimin ankimor që të njëjtin ta kthej në vendin e tij të punës me të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës, pasi që me Aktvendimin PKR.nr.130/16 të datës 08.11.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë ka pushuar procedura penale ndaj tij, e iniciuar me Aktakuzën e Prokurorisë Specialë të EULEX-it PPS.36/14 të datës 03.03.2016.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 07.12.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Më datë 24.12.2021 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritator ka administruar këto prova: Ankesën A.nr.997/2021 të datës 03.12.2021 të parashtruar nga ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin e datës 19.09.2014 lidhur me pezullimin parandalues të ankuesit; kërkesën me nr.prot:4591 të datës 17.11.2021 për kthimin e vendim e punës të Aktvendimin PKR.nr.130/16 të datës 08.11.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Parashtrësën e datës 24.12.2021, Vendimin me numër 1292/2021 të datës 14.12.2021, Përgjigjen në ankesë të datës 21.12.2021, Akt Emërimin me numër reference 35/DL 9 të datës 18.08.2014, Kushtet e punësimit për pozitën e punës Kryesues i Njësisë për Përfaqësim Ligjor"; Vendimin nr.prot:7207 të datës 19.09.2014, Vendimin nr.prot:138 të datës 12.01.2015.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës, ka konstatuar së ekziston baza ligjore për përfundimin e procedimit administrativ të filluar me ankesën e ankuesit *sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës është konstatuar se ankuesi më datë 03.12.2021, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovë kundër heshtjes Administrative të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, me pretendimin ankimor që të njëjtin ta kthej në vendin e tij të punës me të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës, pasi që me Aktvendimin PKR.nr.130/16 të datës 08.11.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë ka pushuar procedura penale ndaj ankuesit e iniciuar me Aktakuzën e Prokurorisë Speciale të EULEX-it PPS.36/14 të datës 03.03.2016. Ndërsa me datë 24.12.2021 ankuesi ka parashtruar kërkesë me numër protokolli 6326/2021, për tërheqjen e ankesës të datës 03.12.2021, andaj, bazuar në këtë veprim të ankuesit, e në kuptim të dispozitave të nenit 103 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me të cilin është përcaktuar se: "Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë", Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave vendosi që të përfundoj procedurën administrative të iniciuar me ankesën e me numër A.nr.997/2021 të datës 03.12.2021.

Ashtu siç u konstatua si me lartë, Kolegji bazuar në nenin 6 pangari 1 nen paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.Nr.997/2021

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

